REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR20529 VENDIMIT

20529

# V E N D I M

## PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me daten 11/01/1999,une gjyqtarja e Gjykates te Rrethit Tirane Amele Cefa ,pasi shqyrtova kerkesen dhe materjalet e paraqitura nga Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "SUCRALBA" SH.P.K,p per regjistrimin si person Juridik:

KONSTATOVA

Se kerkuesi ka paraqitur kerkese per regjistrimin si person Juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SUCRALBA"SH.P.K me ortak subjektet:SFIR(Società Fondaria Industriale Romagnola S.p.A)person Juridik Italian;OERT SH.P.K person Juridik Shqiptar dhe SIMEST S.p.A person Juridik Italian.me kohezgjatje te Shoqerise 50(pesedhjet) vjet,me qender legale ne Durres Rruga "Dalip Peza" Nr 12 ,me kapital themeltar 215.266.800(dyqintepesembedhjetmilionedyqintegjashtedhjetegjashtemijeeteteqint)leke.e barazvlefeshme 2.450.000.000 lireta,me perqindje te pjesmarjes ne kapitalin themeltar:SFIR 92.608.656 leke qe perfaqson 43,02 % te kapitalit themeltar:"OERT"SH.P.Kme pjesmarje ne kapitalin themeltar 90.412.056 leke nga te cilat kontribon ne natyre ne leke 74.684.800 leke dhe para 15.727.656 leke qe perfaqsojne 42 % te kapitalit themeltar dhe "SIMEST" S.p.A me pjesmarje ne kapitalin themeltar ne shumen 32.246.088 leke qe perfaqson 14,98 % te kapitalit themeltar.Administrator te Shoqerise jane emeruar Z. Lefter Koka dhe Z. Alberto Cacciaguerra.

Objekti i veprimtarise te Shoqerise eshte:"Ndertimi i linjes te prodhimit dhe venia ne shfrytezim e impiantit prodhues dhe perpunimi dhe shitja e sheqerit te konfeksionuar dhe ne thase si dhe e prodhimeve te tjera ushqimore,me te gjitha perpunimet plotesues te domozdoshem ,ose te nevojshem ,ne vartesi me llojet e ndryshme te prodhimit .Ky objekt i veprimtarise mund te realizohet teresisht ne menyre progresive .Per arritjen e objektit te shoqerise dhe piksynime-

vet per realizimin e tij ,ajo do te ndermar dhe do te zhvilloje çfardolloj veprimtarie industriale,tregtare ,me pronesite e sendevet te palujteshme dhe financiare ,qe do te konsiderohen te dobishme dhe te pershtateshme per qellimet e shoqerise".

Dokumentacioni i paraqitur eshte i plote ,i bazuar ne ligj dhe si e tille kerkesa duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992:"Per shoqerite Tregtare" si dhe ligjit 7667 date 28.01.1993"Per regjistrin Tregtar".

V E N D O S A

Regjistrimin si person Juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SUCRALBA" SH.P.K ,me Ortak SFIR Sp.A Person Juridik Italian;"OERT"SH.P. Person Juridik Shqiptar;SIMEST S.p.A person Juridik Italian ,me kohezgjatje te shoqerise 50(Pesedhjet) vjet,me qender ne Durres Rruga "Dalip Peza" Nr 12 me kapital themeltar 215.266.800 leke e barazvlefshme 2.450.000.000 lireta ,me perqindje te pjesmarjes ne kapitalin themeltar :SFIR S.p.A 92.608.656 leke qe perfaqson 43,02 % te kapitalit themeltar;OERT SH.P.K 90.412.056 leke nga te cilat kontribut ne natyre 74.684.800 leke dhe derdhje 15.727.656 leke qe perfaqsojne 42 % te kapitalit themeltar dhe SIMEST S.p.A ,me pjesmarje ne kapitalin themeltar ne shumen 32.246.088 leke qe perfaqson 14,98 % te kapitalit themeltar.Administrator te Shoqerise jane Z.Lefter Koka dhe Z.Alberto Cacciiaguerra.

Objekti i veprimtarise te Shoqerise eshte:"Ndertimi i linjes te prodhimit dhe venia ne shfytezim e impiantit prodhues dhe perpunimi dhe shitja e sheqerit te konfeksionuar dhe ne thase si dhe e prodhimevet te tjera ushqimore ,me te gjitha perpunimet plotesuese te domozdoshem ,ose te nevojshem ne vartesi me llojet e ndryshme te prodhimit .Ky objekt i veprimtarise mund te realizohet teresisht

ne menyre progresive .Per arritjen e objektit te Shoqerise dhe piksy-nimevet per realizimin e tij,ajo do te ndermar dhe do te zhvilloj çfardolloj veprimtarie industriale,tregtare,me pronesite e sendevet te palujteshme dhe financiare,qe do te konsiderohen te dobishme dhe te pershtateshme per qellimet e shoqerise".

Kunder vendimit lejohet ankim.

G J Y Q T A R

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 20529/1 Vendimi

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane,sot me date 13/11/2002 une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se pare Tirane, Pranvera Cafo , mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Lefter Koka , administrator I shoqerise " Sucralba " shpk, dhe :

KONSTATOVA

Se shoqeria " Sucralba " shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane,me ortake shoqerine italiane "SFIR" s.p.a., "OERT" sh.p.k. dhe shoqerine italiane "Simest" s.p.a., me administrator z. Lefter Koka.

Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., ne prezence te ortakeve qe zoterojne 85 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, shoqeria "SFIR" s.p.a. dhe "OERT" sh.p.k., me date 12.11.2002, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, bazuar ne nenin 7 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 12 te Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

1- Aprovimin e kerkeses se ortakut "SFIR" s.p.a. per shitjen e 1054 kuotave (43.02%) te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k., shoqerise italiane "FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA" s.p.a.
2- Pranimin e shoqerise "FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA" s.p.a. si ortake te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. , si pjemarres me 43.02 % (1054 kuota) te kapitalit themeltar te shoqerise.
3- Ndryshimin e Statutit te shoqerise per sa I perket pjesmarresve si ortake te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. dhe kuotave te zoteruara prej tyre.
4- Pasqyrimin e ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Ne vijim te ketij vendimi, midis shoqerive "SFIR" s.p.a. dhe "FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA" s.p.a. u nenshkrua kontrata e shitblerjes se kuotave me date 12.11.2002 me ane te se ciles shoqeria "FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA" s.p.a. behet ortake e shoqerise "Sucralba" sh.p.k. me 43.02 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit 7667 date 28/01/1993 dhe ligjit 7638 date 19/11/1992 .

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e Vendimit date 12.11.2002 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise " Sucralba " shpk, te kontrates se shitblerjes se kuotave dhe te akteve per ndryshimet ne Statutin e shoqerise.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise ne kollonen ___,reshti ____.

Tirane,me 13/11/2002

GJYQTARE

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE***
***Nr.20529/2 VENDIMI***

***V E N D I M***

***I GJYQTARIT TE VETEM***

Ne Tirane, sot me date 16 /07/2004, une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Ariana Ceco, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ilir Koka, per depozitimin e dokumenteve per ndryshime ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k. Durres,

***K O N S T A T O V A*** :

Se Shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane. Shoqeria perbehet prej tre ortakesh, shoqerise italiane "SFIR"s.p.a., shoqerise "OERT" sh.p.k. dhe shoqerise italiane "SIMEST"s.p.a..
Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., me Vendimin date 30/06/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, bazuar ne nenin 7 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 12 te Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

1- Aprovimin e kerkeses se ortakut SIMEST S.p.A. per shitjen e 367 kuotave (14.98 %) te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqerine "SUCRALBA" sh.p.k., shoqerise FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a.
2- Ndryshimin e Statutit dhe Aktit te Themelimit per sa i perket pjesmarresve si ortake te "SUCRALBA" sh.p.k. qe ndryshon dhe behet:
   - shoqeria FSII S.p.A. me 1421 kuota ose 58 % te kapitalit themeltar
   - shoqeria OERT sh.p.k. me 1029 kuota ose 42 % te kapitalit themeltar
3- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Ne vijim te ketij vendimi, midis SIMEST s.p.a. dhe FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. u nenshkrua kontrata e shitblerjes se kuotave me Nr.1276 Rep./199 Kol. date 30/06/2004, me ane te se ciles shoqeria FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. behet ortake e shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k. me 58 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa e tij eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

***PER KETO ARSYE***

Ne baze te Ligjit Nr. 7667 date 20 janar 1993,

### *VENDOSA*

1. Pranimin e kerkeses.

2. Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve date 30/06/2004 e te Kontrates se shitblerjes se kuotave.

3. Urdherimin e zyres se Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimin ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen _______.

***GJYQTARE***

Ariana Ceco

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE***
***Nr.*** 20529/3 ***VENDIMI***

***V E N D I M***

***I GJYQTARIT TE VETEM***

Ne Tirane, sot me date 27/09/2004, une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Ariana Ceco, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ilir Koka, per depozitimin e dokumenteve per ndryshime ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k. Durres,

***K O N S T A T O V A*** :

Se Shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane.
Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., me Vendimin date 22/09/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, bazuar ne nenin 4 te Kontrates se shitblerjes se kuotave dhe ne nenin 12 te Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

1- Transferimin e plote te pronesise se 1421 kuota ose 58 % te kapitalit themeltar te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. te ortaku shoqeria "OERT" sh.p.k.
2- Largimin e shoqerise "Finanziaria Saccarifera Italo Iberica" S.p.A. nga pjesmarrja ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k.
3- Ndryshimin e Statutit dhe aktit te themelimit per sa i perket pjesmarresve si ortake te "Sucralba" sh.p.k. qe ndryshon dhe behet:
   - shoqeria "OERT" sh.p.k. me 2450 kuota ose 100 % te kapitalit themeltar.
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa e tij eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

***PER KETO ARSYE***

Ne baze te Ligjit Nr. 7667 date 20 janar 1993,

***V E N D O S A***

1. Pranimin e kerkeses.

2. Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve date 22/09/2004.
3. Pasqyrimin e ndryshimit te pjesmarrjes se ortakeve ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k. qe ndrshon dhe behet:
- shoqeria "OERT" sh.p.k. me 2450 kuota, ose 100 % te kapitalit themeltar.
4. Urdherimin e zyres se Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimin ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen _______.

***GJYQTARE***

Ariana Coço

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE***
***Nr.20529/14 VENDIMI***

20529

## *V E N D I M*

## *I GJYQTARIT TE VETEM*

Ne Tirane, sot me date 04/10/2004, une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Ariana Ceco, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ilir Koka, per depozitimin e dokumenteve per ndryshimin e Statutit te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. Durres,

## *K O N S T A T O V A* :

Se shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., e perbere nga ortaku i vetem, shoqeria "OERT" sh.p.k., me Vendimin date 04/10/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, ka vendosur:

1- Ndryshimin e statutit te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. duke e pershtatur me gjendjen aktuale te saj, ne lidhje me ortakun e vetem te saj, shoqerine "OERT" sh.p.k. dhe zoterimin prej saj te 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te "Sucralba" sh.p.k.
2- Miratimin e Statutit te ri te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. te riformuluar, bashkangjitur ketij vendimi.
3- Autorizohet administratori i shoqerise z. Ilir Koka te nenshkruaje te gjitha aktet e nevojshme per pasqyrimin e ketij ndryshimi.
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa e tij eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## *PER KETO ARSYE*

Ne baze te Ligjit Nr. 7667 date 20 janar 1993,

*V E N D O S A*

1. Pranimin e kerkeses.

2. Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve date 04/10/2004 dhe te Statutit te ri te shoqerise “Sucralaba” sh.p.k.

3. Urdherimin e zyres se Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimin ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen _______.

***GJYQTARE***

Ariana Coco

# AKTI I THEMELIMIT
# TE SHOQERISE
# ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "SUCRALBA" Sh.p.k.

Subjektet nënshkrues që vijojnë :

- SFIR - Società Fondaria Industriale Romagnola, S.p.A., person juridik italian me kapital themeltar 13.740.810.000 Lireta, me seli në Cesena (FO), Rruga B. Croce n. 7, 47023, kodi fiskal 00304660376, P. IVA 01672790407, e përfaqësuar me të gjitha efektet e këtij akti nga dr Mario Riciputi, lindur në Cesena, banues në Cesena, Rruga Isei n. 11, me numër pasaporte 318566A, për firmosjen e këtij akti, i pajisur me të gjitha të drejtat të lëshuara nga Këshilli i Administrimit, në bazë të verbalit datë 30.03.1998, e cila i lidhet këtij akti (si Lidhja nr. 1);
- OERT Sh.p.k., person juridik shqiptar, me kapital themeltar lekë 100.000 me seli në Durrës, Rruga Dalip Peza n. 12, kodi fiskal 550520, me nr. NIPT J61818569W e përfaqësuar nga z. Lefter Koka, me cilësinë e Administratorit të Vetëm lindur në Durrës, banues në Durrës, Rruga Koço Kazanxhi, me numër pasaporte 0307047,
- SIMEST S.p.A. në Romë, person juridik italian, me kapital themeltar në Lireta 316.627.369.000, me seli në Romë, Rruga Alessandro Farnese n. 4, 00192, kodi fiskal 04102891001, e përfaqësuar nga zonja Toffoli Flavia, lindur në Sesto al Reghena (PN), dhe banuese në Romë, Rruga Cesare Pascarella, n. 34, me numër pasaporte 8342465, për firmosjen e këtij akti, pajisur me prokurë të rregullt noteriale, të lëshuar nga Presidenti i SIMEST S.p.A., Dr. Ruggero Manciati, e cila i lidhet këtij akti (si Lidhja nr. 2);

kanë rënë dakord të lidhin kontratën e mëposhtme për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, në referim të veçantë (por jo të përjashtuar) të Ligjit n. 7764 datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja", të Ligjit n. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të Ligjit n. 8267 datë 19.12.1997 "Për Agjensinë Shqiptare të Garancisë", si dhe të ligjeve që do të dalin gjatë periudhës në të cilën shoqëria do të ekzistojë, veprimtaria e së cilës do të rregullohet nga Statuti i saj, që është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, së cilës i është bashkëngjitur (si Lidhja n. 3).

**Neni 1**

Emri i shoqërisë është "SUCRALBA" Sh.p.k.

**Neni 2**

Qendra legale është caktuar të jetë në Durrës, Rruga Dalip Peza n. 12, Shqipëri. Qendra operative e shoqërisë është stabilimenti industrial në Durrës, Rruga Dalip Peza n. 12.

**Neni 3**

Kohëzgjatja e shoqërisë është 50 (pesëdhjetë) vjet nga data e rregjistrimit në Rregjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

**Neni 4**

Objekti i shoqërisë është:

"Ndërtimi i linjës së prodhimit dhe vënia në shfrytëzim e impiantit prodhues dhe përpunimi dhe shitja e sheqerit të konfeksionuar dhe në thasë, si dhe e prodhimeve të tjerë ushqimore, me të gjitha përpunimet plotësuese të domosdoshëm ose të nevojshëm, në vartësi me llojet e ndryshme të prodhimit".

Ky objekt i veprimtarisë mund të realizohet tërësisht në mënyrë progresive.

Për arritjen e objektit të shoqërisë dhe të piksynimeve për realizimin e tij, ajo do të ndërmarrë dhe do të zhvillojë çfarëdo lloj veprimtarie industriale, tregtare, me pronësitë e sendeve të paluajtshme, dhe financiare, që do të konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme për qëllimet e shoqërisë.

**Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 215.266.800 lekë, e barazvlefshme me 2.450.000.000 lireta italiane, të rezultuara nga kontributet e ortakëve, e llogaritur sipas kursit zyrtar të këmbimit të 1 lek = 11,381225 Lireta, të vendosur nga Banka e Shqipërisë në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Ky kapital rezulton nga kontributet e përgjithëshme te ortakëve, nga të cilët në natyrë lekë 74.684.400, e barazvlefshme me 850 milion lireta italiane dhe në para lekë 140.582.400 e barazvlefshme me 1.600 milion lireta.

Në veçanti, kontributet e ortakëve janë të tilla:

- SFIR S.p.A. kontribuon në lekë për shoqërinë Lekë 92.608.656, e barazvlefshme me lireta 1.054.000.000, sipas kursit zyrtar të këmbimit të

sipërpërmendur.

- OERT Sh.p.k. kontribuon në natyrë, në lekë ...74.684.400..., e barazvlefshme me lireta 850.000.000, sipas kursit zyrtar të këmbimit të sipërpërmendur, nëpërmjet transferimit në pronësi të shoqërisë të terrenit dhe të stabilimentit industrial me vendndodhje në Durrës, karakteristikat dhe të dhënat kadastrale të të cilëve janë të treguara në aktin e transferimit të redaktuar nga noteri Piro Tili, më datë 14-07-97, që i bashkëlidhet kontratës si Lidhja n. 4, së bashku me aktin e vlerësimit të ekspertit të autorizuar të caktuar nga Gjykata; kontribuon gjithashtu në para, ...15.727.656............ lekë e barazvlefshme me lireta 179.000.000, sipas kursit zyrtar të këmbimit të sipërpërmendur.

- SIMEST S.p.A. kontribuon për shoqërinë në para lekë ...32.246.088..., e barazvlefshme me lireta 367.000.000 sipas kursit zyrtar të këmbimit të sipërpërmendur.

**Neni 6**

Kapitali themeltar është i ndarë në 2.450 (dymijëkatërqindepesëdhjetë) pjesë, të vlerës në lireta 1 milion seicila, tërësisht të nënshkruara e të shlyera, duke patur secila prej tyre një vlerë nominale prej ...87.864...... lekë, . . . . . . . . .

Sipas kontributeve të sipërcituara :

- SFIR S.p.A. i përkasin 1054 pjesë, që i korrespondojnë 43,02% të kapitalit themeltar;
- OERT Sh.p.k. i përkasin 1029 pjesë, që i korrespondojnë 42% të kapitalit themeltar;
- SIMEST S.p.A. i përkasin 367 pjesë, që i korrespondojnë 14,98% të kapitalit themeltar.

Shumat e derdhura në lekë nga ortakët janë të kredituara në një llogari të hapur në emër të shoqërisë, pranë Bankës Italo-Shqiptare në Tiranë (mandatet e derdhjeve përkatëse iu janë bashkëngjitur si Lidhja 5).

**Neni 7**

Në ndryshim dhe plotësim për sa është parashikuar në nenin 12 të Statutit ("Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar") nënkuptohet që tani :

- SIMEST S.p.A. mund, që me gjykimin e saj të pakontestueshëm, t'ikalojë ose t'i transferojë SFIR S.p.A., sipas asaj që kanë rënë dakord SFIR dhe SIMEST, pjesët e kapitalit themeltar të nënshkruara, prej saj, brenda 8-vjetëve duke filluar nga

data e nënshkrimit të këtij akti.

- OERT Sh.p.k. në mënyrë të paprapësueshme lejon dhe pranon një veprim të tillë kalimi (ashtu si edhe veprime analoge të kalimit në mënyrë të pjesëshme ose tërësore të pjesëve të kapitalit themeltar të nënshkruara nga SFIR S.p.A), edhe shoqërive të kontrolluara ose atyre në të cilat ajo është vetë pjesëmarrëse, derisa synon në objektivin e përforcimit të shoqërisë, dhe heqin dorë në mënyrë të paprapësueshme prej së drejtës së parablerjes për të cilën bëhet fjalë në këtë paragraf, të parashikuar nga neni 12 i Statutit.

**Neni 8**

Shoqëria do të administrohet nga dy Administratorë, të cilët mund të jenë edhe jashtë bashkësisë së ortakëve.

Administratorët zgjidhen nga Asamblea e ortakëve me një kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh dhe mund te rizgjidhen për periudhat e mëvonshme.

Me anë të këtij akti emërohen Administratorë të parë zotërinjtë:

- Z. Lefter Koka , lindur në Durrës, më 4-08-1964;
- Dr Alberto Cacciaguerra, lindur në Longiano (FO), më 10-11-1934.

Ortakët u kalojnë Administratorëve të gjitha fuqitë e domosdoshme për të kryer (edhe veç e veç) të gjitha formalitetet dhe detyrimet e kërkuara për themelimin e shoqërisë, sipas legjislacionit dhe normave në fuqi.

Ata do të jenë, gjithashtu të autorizuar që të veprojnë në emër të shoqërisë, që themelohet, deri në rregjistrimin e saj në Gjykatë. Ata janë, gjithashtu, të pajisur me mandat për të firmosur të gjitha aktet dhe të shlyejnë në emër të shoqërisë detyrimet, që lindin nga momenti i rregjistrimit të saj pranë të njëjtës Gjykatë.

Statuti do të parashikojë kufizimet dhe atribuimin e kompetencave, që u përkasin administratorëve.

**Neni 9**

Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e paraqitjes së këtij akti, shoqëria do të përgatisë dhe do të fillojë një program të përshtatshëm për formim dhe asistencë teknike në favor të personelit të saj.

**Neni 10**

Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacionit teknik, informacionet dhe eksperiencat e shkëmbyera ndërmjet tyre në fazën e

përgatitjes së shoqërisë, si edhe për sa u takon atyre, për të cilat do të vinë në dijeni ose në dorëzim gjatë veprimtarisë së ardhshme të saj.

**Neni 11**

Kushtet e punës, paga, orari i punës, pushimet dhe trajtimi i sigurimit shoqëror të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive dhe individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi, për aq sa nuk janë përcaktuar nga kontratat në fjalë.

**Neni 12**

Të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin nga interpretimet, aplikimin dhe zgjidhjen e kontratës së themelimit dhe të statutit të shoqërisë, si dhe në përgjithësi, ato që mund të lindin ndërmjet ortakëve (me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet personale apo jashtëshoqërore) ose ndërmjet njërit ose më shumë ortakëve dhe shoqërisë, do të zgjidhen në parim, me mirëkuptim dhe të diskutuara drejtpërsëdrejti ndërmjet të interesuarve.

**Neni 13**

Në rast të mungesës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet Gjykatës Shqiptare, por ortakët italianë kanë të drejtën e alternativës për të kërkuar që mosmarrëveshjet të gjykohen nga Arbitrazhi i Dhomës së Tregtisë së Parisit, që do të caktojë një gjykatë, sipas rregullave të përcaktuara nga vetë ajo.
Ortaku shqiptar njeh dhe pranon që tani të drejtën e paprapësueshme të ortakëve italianë.

**Neni 14**

Viti i parë ushtrimor financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e rregjistrimit të saj pranë Gjykatës së Tiranës, dhe do të përfundojë më 31.10.1999.

**Neni 15**

Ky akt themelimi dhe statuti bashkëlidhur janë redaktuar në Tiranë më 3.12.'98, dhe përpiluar në 8 (tetë) kopje origjinale, 4 (katër) prej të cilave në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) në gjuhën italiane, të gjitha me të njëjtën efektshmëri interpretimi.
Lexuar, firmosur dhe nënshkruar.

- për SFIR S.p.A. ....................................................................

- për OERT Sh.p.k. .................................................................

- për SIMEST S.p.A. ..............................................................

**STATUTI**

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

# "SUCRALBA" Sh.p.k.

Subjektet nënshkrues që vijojnë :

- SFIR - Società Fondaria Industriale Romagnola, S.p.A., person juridik italian me kapital themeltar 13.740.810.000 Lireta, me seli në Cesena (FO), Rruga B. Croce n. 7, 47023, kodi fiskal 00304660376, P. IVA 01672790407, e përfaqësuar me të gjitha efektet e këtij akti nga dr Mario Riciputi, lindur në Cesena, banues në Cesena, Rruga Isei n. 11, me numër pasaporte 318566A, për firmosjen e këtij akti, i pajisur me të gjitha të drejtat të lëshuara nga Këshilli i Administrimit, në bazë të verbalit datë 30.03.1998, e cila i lidhet këtij akti (si Lidhja nr. 1);

- OERT Sh.p.k., person juridik shqiptar, me kapital themeltar lekë 100.000 me seli në Durrës, Rruga Dalip Peza n. 12, kodi fiskal 550520, me nr. NIPT J61818569W e përfaqësuar nga z. Lefter Koka, me cilësinë e Administratorit të Vetëm lindur në Durrës, banues në Durrës, Rruga Koço Kazanxhi, me numër pasaporte 0307047,

- SIMEST S.p.A. në Romë, person juridik italian, me kapital themeltar në Lireta 316.627.369.000, me seli në Romë, Rruga Alessandro Farnese n. 4, 00192, kodi fiskal 04102891001, e përfaqësuar nga zonja Toffoli Flavia, lindur në Sesto al Reghena (PN), dhe banuese në Romë, Rruga Cesare Pascarella, n. 34, me numër pasaporte 834246S, për firmosjen e këtij akti, pajisur me prokurë të rregullt noteriale, të lëshuar nga Presidenti i SIMEST S.p.A., Dr. Ruggero Manciati, e cila i lidhet këtij akti (si Lidhja nr. 2);

kanë rënë dakord që ditën e sotme të nënshkruajnë këtë statut për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

## KAPITULLI I
## EMRI, OBJEKTI, QENDRA, KOHEZGJATJA

### Neni 1 - Tipi

"SUCRALBA" Sh.p.k. është krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet nga ky statut dhe nga akti i themelimit të saj.

Shoqëria vepron sipas Legjislacionit shqiptar në fuqi, në mënyrë të veçantë (por

jo të përjashtuar) në referim të neneve 11 dhe 12 të Ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të Ligjit n. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja", të Ligjit nr. 8267, datë 19.12.1997 "Për Agjensinë Shqiptare të Garancisë" dhe ligje të tjera që do të dalin gjatë periudhës të veprimtarisë së shoqërisë.

Akti i themelimit dhe statuti janë në konformitet me legjislacionin shqiptar, me karakter të detyrueshëm, dhe plotësohen, për aq sa në to nuk është parshikuar, nga legjislacioni shqiptar.

Shoqëria fiton personalitet juridik shqiptar nga dita e rregjistrimit të saj pranë Rregjistrit Tregtar të Tiranës.

**Neni 2 - Emri**

Emëri i Shoqërisë është "SUCRALBA" Sh.p.k.

**Neni 3 - Objekti**

Objekti i shoqërisë është si më poshtë :

"Ndërtimi i linjës së prodhimit dhe vënia në shfrytëzim e impiantit prodhues dhe përpunimi dhe shitja e sheqerit të konfeksionuar dhe në thasë, si dhe e prodhimeve të tjerë ushqimore, me të gjitha përpunimet plotësuese të domosdoshëm ose të nevojshëm, në vartësi me llojet e ndryshme të prodhimit".

Ky objekt i veprimtarisë mund të realizohet tërësisht në mënyrë progresive.

Për arritjen e objektit të shoqërisë dhe të piksynimeve për realizimin e tij, ajo do të ndërmarrë dhe do të zhvillojë çfarëdo lloj veprimtarie industriale, tregtare, me pronësitë e sendeve të paluajtshme dhe financiare, që do të konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme për qëllimet e shoqërisë.

**Neni 4 - Parimet e administrimit dhe të zbatimit të aktit themelimit dhe të statutit**

Parimet, klauzolat, të drejtat dhe detyrimet, që rezultojnë nga akti themelimit dhe/ose nga statuti nuk mund të ndryshohen ose modifikohen, veçse me vendim të Asamblesë së ortakëve.

Sipas legjislacionit shqiptar - dhe në mënyrë të veçantë të Ligjit nr. 7764, datë 02.11.1993, si dhe Ligjit nr. 8267, datë 19.12.1997 "Për Agjensinë Shqiptare të Garancisë", veprimtaria e sipërmarrjes dhe investimet e ortakëve italianë janë të mbrojtura nga Shteti Shqiptar.

Ortakët italianë kanë të drejtë të transferojnë fitimet e tyre jashtë shtetit në valutë të huaj të zgjedhur nga ata vetë.
Ortakët kanë detyrimin të ruajnë sekretin e dokumentacionit, të informacioneve, të të dhënave dhe të eksperiencave, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e tyre ose të atyre për të cilët vijnë në dijeni.

**Neni 5 - Qendra**

Qendra legale e shoqërisë është caktuar në Durrës, Rruga Dalip Peza nr. 12, Shqipëri.
Qendra operative e shoqërisë është e fiksuar pranë stabilimentit industrial në Durrës, Rruga Dalip Peza nr. 12.
Transferimi i qendrës së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me aprovimin e ortakëve, që zotërojnë 3/4 e pjesës së kapitalit themeltar.
Asamblea mund të vendosë hapjen e filialeve, të degëve dhe të përfaqësive në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj, me vendim të shumicës, d.m.th. 3/4 të votave të shprehura.

**Neni 6 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë 50 vjeçare duke filluar nga data e rregjistrimit të saj pranë Gjykatës.
Shoqëria mund të prishet para kohe ose të shtyjë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.

**Neni 7 - Përgjegjësia**

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet, që nuk kanë të bëjnë me qëllimet e përcaktuara në Statutin dhe Aktin i Themelimit.
Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët ndaj personave të tretë, Enteve dhe Shtetit.

## KAPITULLI II
## KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET
## NDARJET E PJESEVE TE SHOQERISE

## Neni 8 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në Lek 215.266.800 (DYQINDEPESEMBEDHJETEMILIONDYQINDEGJASHTEDHJETEGJASHTEMIJE E TETEQIND)

Kapitali themeltar është i ndarë në 2.450 (dymijëekatërqindepesëdhjetë) pjesë, tërësisht të nënshkruara e të shlyera, duke patur secila prej tyre një vlerë nominale prej 87.864 lekë.

Fondet e ardhura nga derdhja në para nga palët depozitohen pranë Bankës Italo-Shqiptare, në një numër llogarie të posaçëm në emër të shoqërisë.

## Neni 9 - Kontributet dhe pjesët

Kontributet e ortakëve përcaktohen si më poshtë:

- SFIR S.p.A. ka kontribuar për shoqërinë në lekë 92.608.656, e barazvlefshme në Lireta 1.054 milion me kursin zyrtar të këmbimit 1 Lek=Lire 11,381225 e stabilizuar nga Banka Shqiptare në datë e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- OERT Sh.p.k. ka kontribuar në natyrë, lekë 74.624.400, nëpërmjet transferimit në pronësi të shoqërisë të terrenit dhe të stabilimentit industrial me vendndodhje në Durrës, sipas aktit të transferimit të redaktuar nga noteri Piro Tili, në datë 14.07.1997, që i bashkëlidhet kontratës si Lidhja n. 4, së bashku me aktin e vlerësimit të ekspertit të autorizuar të caktuar nga Gjykata; ka kontribuar, gjithashtu në para shumën 15.727.656 lekë, e barazvlefshme me kundërvlerën në Lireta 179.000.000, sipas kursit zyrtar të sipërpërmendur.
- SIMEST S.p.A. ka kontribuar në para në lekë 32.246.088, e barazvlefshme me kundërvlerën në lireta 367.000.000 sipas kursit zyrtar të këmbimit të sipërpërmendur.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2.450 (dymijëekatërqindepesëdhjetë) pjesë, tërësisht të nënshkruara e të shlyera.

Sipas kontributeve të sipërcituara :

- SFIR S.p.A. i përkasin 1.054 pjesë, që i korrespondojnë 43,02% të kapitalit themeltar;
- OERT Sh.p.k. i përkasin 1.029 pjesë, që i korrespondojnë 42% të kapitalit themeltar;
- SIMEST S.p.A. i përkasin 367 pjesë, që i korrespondojnë 14,98% të kapitalit themeltar.

Shumat e derdhura në lekë nga ortakët janë të kredituara në një llogari të hapur

në emër të shoqërisë, pranë Bankës Italo-Shqiptare në Tiranë (mandati i derdhjes përkatës është bashkëngjitur si Lidhja 5).

**Neni 10 - Shtimi i kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar mund të shtohet pa kufi, në çfarëdo momenti, një ose më shumë herë, me vota të shprehura në Asamblenë e Jashtëzakonshme të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën 3/4 e kapitalit themeltar.

Në rastin kur vendoset shtimi i kapitalit themeltar, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë shtimin në raport me pjesët e kapitalit që zotërojnë. Në rast se nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakë të tjerë në mënyrë proporcionale sipas kuotave që ata zotërojnë.

**Neni 11 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar, nëpërmjet votimit të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën 3/4 e kapitalit themeltar.

Zvogëlimi i kapitalit bëhet nga secili ortak në mënyrë proporcionale me kuotat që zotëron.

**Neni 12 - Transferimi i pjesëve**

Pjesët mund tu transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve, që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit themeltar.

Në çdo rast pjesët duhet tu ofrohen me përparësi ortakëve; vetëm në rast se ata heqin dorë, do tu kalohen të tretëve, me kusht që transferimi të mos jetë më i leverdisshëm për blerësin në raport me ato të propozuara ortakëve.

Megjithatë, janë të vlefshme përjashtimet e parashikuara nga neni 7 i Aktit të Themelimit.

## KAPITULLI III
## ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET, KONTROLLI

**Neni 13 - Asamblea e ortakëve dhe fuqitë përkatëse**

Organi vendimor i Shoqërisë është Asamblea e ortakëve.

Vendimet e saja të marra nga shumica e votave janë të detyrueshme për ortakët, që mungojnë ose të atyre që janë kundër, përveç të drejtës së kundërshtimit, që ata kanë për ta ushtruar në rastet, afatet dhe format e përcaktuara nga ligji.

**Neni 14 - Të drejtat e pjesëmarrjes dhe të votës**

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të shprehë aq vota aq sa janë pjesët e kapitalit themeltar të derdhura nga ai.

**Neni 15 - Thirrja e Asamblesë**

Asamblea e zakonshme duhet të thirret së paku një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor për aprovimin e bilancit, të relacioneve të Administratorëve dhe të ekspertit kontabël, si dhe për inventarin.

Mund të thirret, gjithashtu në çfarëdo lloj momenti nga Administratorët ose nga Eksperti kontabël, ose nga likuidatorët kur ata e shohin të nevojshme, si dhe nga një ose shumë ortakë, që përfaqësojnë më shumë se 1/10 e kapitalit themeltar.

Asamblea duhet të thirret me letër rekomande të postuar ortakëve - në vendqëndrimin, që rezulton nga Libri i Ortakëve - dhe ekspertit kontabël (në se është emëruar) së paku 30 (tridhjetë) ditë përpara. Thirrja duhet të përmbajë tregimin e tipit të Asamblesë, të lëndës që do të trajtohet dhe do të vendoset, vëndin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë të Asamblesë.

Asamblea mbahet rregullisht e thirrur dhe konsiderohet e vlefshme edhe pa u respektuar këto formalitete, nëse në të marrin pjesë ose janë të përfaqësuar të gjithë ortakët, të gjithë administratorët dhe eksperti kontabël (në se është emëruar).

Ortakët mund të përfaqësohen nga ortakë të tjerë ose nga të tretët.

Sipas rëndësisë së vendimeve, Asamblea mund të jetë e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme.

Asamblea e Zakonshme trajton të gjitha çështjet, që nuk vendosen nga Asamblea e Jashtëzakonshme, të përcaktuara nga statuti ose nga ligji, si dhe për emërimin ose revokimin e Administratorëve dhe të ekspertit kontabël (në se është emëruar); aprovon planet e prodhimit, organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë dhe bilancin preventiv, bilancet periodike të vitit ushtrimor, relacionet e Administratorëve dhe të ekspertit kontabël, inventarin; vendos mbi shpërndarjen e fitimeve.

Asamblea e Zakonshme është e vlefshme dhe mund të vendosë, në se është

prezente ose i përfaqësuar më shumë se 50% e kapitalit themeltar të shoqërisë.
Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, Asamblea duhet të mblidhet për herë të dytë dhe mund të mbahet e të vendosë me shumicë, cilido që të jetë numri i ortakëve prezent ose të përfaqësuar dhe votues, përveç rastit të emërimit dhe revokimit të Administratorëve. Në këtë rast, ortakët e pranishëm dhe votat e dhëna nga ortakët, që votojnë ose të përfaqësuar duhet të kalojnë 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar dhe në mbledhjen e dytë.
Asamblea e Jashtëzakonshme konsiderohet e vlefshme dhe vendos në mbledhjen e parë ose të dytë, me praninë së paku të 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit themeltar dhe me votë të favorshme të aq ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar dhe votues që përfaqësojnë, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në të dytën, të paktën 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
Asamblea e Jashtëzakonshme, mbahet me asistencën e një noteri për të shkruar proçes-verbalin e mbledhjes, vendos mbi ndryshimet e aktit të themelimit dhe të statutit; mbi krijimin e filialeve, të degëve dhe përfaqësive jashtë shtetit; mbi shtimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar; mbi zhvillimin e veprimtarive të reja dhe marrjen përsipër në to të pjesëmarrjes; mbi transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar, kur kërkohet nga Statuti; mbi emërimin dhe revokimin e likuidatorëve.
Çdo Asamble drejtohet nga Administratorët ose nga ndonjë ortak tjetër i caktuar nga vetë Asamblea. Për mbajtjen e proçes-verbalit, Asamblea emëron një sekretar, qoftë ky edhe jo ortak.
Vendimet e Asamblesë duhet të hidhen në proçes-verbal, dhe nënshkruhen nga Administratori/ët dhe nga sekretari ose noteri. Në proçes-verbal, duhet të hidhen gjithashtu, me kërkesë të ortakëve, deklarimet e bëra prej tyre.

### Neni 16 - Administrimi

Shoqëria administrohet nga 2 (dy) administratorë edhe jo ortakë, që emërohen ose revokohen qoftë edhe veç e veç nga Asamblea e Zakonshme me aprovim së shumicës së ortakëve votues ose të përfaqësuar, që përfaqësojnë, edhe në mbledhjen e dytë, më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
Mandati i tyre ka një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh financiare, me mundësi për tu rizgjedhur.
Administratorët kanë të gjitha fuqitë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, që përshihen në objektin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që

ligji ose statuti i rezervon asamblesë.

Në mënyrë të veçantë, Asmableja ka për kompetencë çështjet si më poshtë:

- blerja ose shitja, edhe nëpërmjet kontratës së qirasë financiare (leasing), të pasurisë së luajtëshme, për vlera më shumë se 3.000.000 lekë për çdo njësi pasurie, ose në kompleks për kategori homogjene të pasurive;
- kontrata të qirasë të pasurive të paluajtshëm;
- marrje e kredive ose e financimeve;
- kërkesë për garanci bankare ose financiare;
- dhënie garancie të çfarëdo lloj tipi.

Seicili administrator do të veprojë me firmë të lirë dhe të ndarë, me përjashtim të çështjeve të mëposhtme, për të cilat duhet të bihet dakord dhe do të veprohet me firmë të përbashkët të të dy administratorëve (të shprehura me pranim edhe nëpërmjet fax):

- marrja në punë, largimet nga puna, promocionet dhe trajtimet disiplinore, trajtimi ekonomik i personelit;
- marrja edhe nëpërmjet kontratës së qirasë financiare (leasing), dhënia e pasurive të luajtshëme për vlera nga 500.000 lekë deri në 3.000.000 lekë;
- shitje dhe blerje të materialeve të lëndëve të para për shuma më të mëdha se 3.000.000 lekë dhe lidhjen e kontratave të furnizimit, në përgjithësi që i kalojnë shumën në 1.000.000 lekë;
- lidhjen e kontratave të sigurimit.

Asamblea e Zakonshme e ortakëve mund të plotësojë ose ndryshojë listën e mësipërme me shumicën e parashikuar për emërimin e administratorëve.

## Neni 17 - Ekspertët kontabël të autorizuar

Në qoftë se është e domosdoshme ose e kërkuar nga ligji, kontrolli i bilancit të vitit ushtrimor dhe të librave kontabël të shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, i emëruar për 1 (një) vit (dhe i rizgjedhshëm) nga e ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet me të njëjtën mënyrë me të cilën është emëruar, në se vërehen gabime në punën e tij, dhe kur gjykohet se nuk është më në gjendje të plotësojë detyrat që i janë ngarkuar.

## KAPITULLI IV
## VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR
## SHPERNDARJA E FITIMEVE

### Neni 18 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 ~~dhjetor~~. tetor.

Bilancet vjetore, inventari, relacioni i administratorëve dhe eventualisht ai i redaktuar nga eksperti kontabël i emëruar, aprovohen nga Asamblea me shumicën e ortakëve, që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

Aprovimi i dokumentave që kanë lidhje me vitin ushtrimor vjetor do të bëhen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

### Neni 19 - Fitimet

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, pasi zbriten 5% (pesë për qind) me destinacion për rezervën ligjore deri në arritjen e 10% të kapitalit themeltar, si dhe pasi zbriten shuma të tjera eventuale të vendosura nga Asamblea, u shpërndahen ortakëve në raport me pjesët e kapitalit themeltar, që posedojnë në mënyrë respektive.

Asamblea mundet për më tepër të vendosë derdhje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera, ose të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, tërësisht ose pjesërisht në vitet ushtrimorë të ardhshëm.

## KAPITULLI V
## PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

### Neni 20 - Prishja

Shoqëria prishet me mbarimin e afatit të kohëzgjatjes të parashikuar në statut, ose përpara mbarimit të këtij afati në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.

Shoqëria nuk prishet në rast të pazotësisë, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

### Neni 21 - Likuidimi

Në rastin e prishjes, shoqëria i nënshtrohet likuidimit.

Për të drejtuar këtë proçedurë Asamblea emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të prezantojnë relacionin përfundimtar mbi gjëndjen e aktivit dhe të pasivit të shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe afatet e domosdoshëm që duhen për të përfunduar proçesin e likuidimit.
Me përfundimin e proçedurës së likuidimit, Asamblea vendos mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likuidatori dhe mbi përfundimin e veprimeve të likuidimit.
Pas pagimit të kreditorëve dhe marrjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve në raport me pjesët, që ata në mënyrë respektive zotërojnë në kapitalin themeltar.

**Neni 22 - Transformimi i shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të transformohet në një shoqëri kolektive ose komandite vetëm me aprovimin unanim të të gjithë ortakëve; ndërsa mund të transformohet në një shoqëri me aksione, (anonime) me aprovim të ortakëve, që zotërojnë shumicën d.m.th. më shumë se 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar, dhe vetëm atëherë kur ortakët të kenë miratuar të paktën bilancin e dy viteve të fundit.

**Neni 23 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

4. Following the transfer of the ownership of the 1421 shares, the transfer will be registered in the "SUCRALBA" sh.p.k. Shareholder's Book and the Buyer shall execute every necessary act with the purpose of effectively accomplishing the transfer of company shares, and to publicly announce this contract according to Albanian Law.

## ARTICLE 5

## CONFLICT RESOLUTION

This contract and the Guarantee are governed by the Italian Law. For every conflict which may arise between the contractual parties, the conditions of this contract, the parties undertake all necessities measures to resolve issues in an amicable manner, if not the Competent Authority will be the Court of Forli / Cesena, Italy for the resolutions of disputes.

This contract is been compiled in 5 (five) copies with the same legal value, in Albanian and in English.

The contract is read and the parties present declare that it is in accordance with their free and full will, and regularly sign in front of me.

Me, the Notary legalize the act in accordance with the law.

| THE SELLER | THE BUYER |
|---|---|
| **FINANZIARIA SACCARIFERRA ITALO IBERICA s.p.a.** | **"OERT" Ltd** |
| **Administrator** | **Administrator** |
| **Alberto Bodini** | **Ilir Koka** |

**Translator:** Enо Bushi

**NOTARY**

Manola Popa

NGA : BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE

DREJTUAR : FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBERICA

Te Nderuar Zoterinj,

Jemi njoftuar se klienti yne OERT Shpk, rr. Dalip Peza, no. 12, ketu i quajtur Bleres, dhe Ju, Finanziaria Saccarifera Italo Iberica spa, ketu te quajtur Shites, keni hyre ne nje Kontrate Shitje te nenshkruar nga te dy palet, per blerjen e kuotave prej 58 % te kapitalit nenshkruar te SUCRALBA shpk, me detyrimin per te kryer pagesat e meposhteme :

- EUR 330.000 ( treqind e tridhjete mije ) jo me vone se 1 Dhjetor 2004
- EUR 330.000 ( treqind e tridhjete mije ) jo me vone se 1 Qershor 2005
- EUR 330.000 ( treqind e tridhjete mije ) jo me vone se 1 Dhjetor 2005

Ne konsiderate te sa siper thene, Ne Banka Amerikane e Shqiperise, detyrohemi ne menyre te pakthyeshme t'ju paguajme cdo shume specifikuar si me siper qe Ju mund te kerkoni nga Ne, por qe te mos kaloje shumen e kestit te skaduar perkundrejt marrjes se nje kerkese te pare te shkruar nga Ju, ku Ju Finanziaria Saccarifera Italo Iberica, deklaroni se Bleresi, deshtoi te respektoje detyrimet kontraktuale te pageses sipas kontrates se siper permendur.

Pagesa nga Banka Amerikane e Shqiperise do te ndodhe brenda maksimumit te periudhes kohore prej 5 ( pese ) dite nga marrja e kerkeses tuaj te pare ne te shkruar, dhe ne asnje rast nuk mund te refuzohet, vonohet apo pezullohet.

Detyrimi yne nen kete garanci do te skadoje ne diten e 30 –te pas skadimit te cdo kesti.

Kjo garanci eshte subjekt

REPUBLIKA E SHQIPERISE
TIRANE

**FROM : AMERICAN BANK OF ALBANIA**

**TO : FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBERICA**

**Dear Messrs,**

We have been informed that our client OERT Shpk, via Dalip Peza no.12, hereinafter called the Buyer, and You, Finanziaria Saccarifera Italo Iberica spa hereinafter called the Seller, have entered in a Sale Contract signed by both parties for the purchase of the quota equal to 58 % of the equity capital of SUCRALBA Shpk, with the obligation to the subsequent payments to the Seller as follows :

- EUR 330.000 ( three hundred thirty thousand ) not later than the first of December 2004
- EUR 330.000 ( three hundred thirty thousand ) not later than the first of June 2005
- EUR 330.000 ( three hundred thirty thousand ) not later than the first of December 2005

In consideration of the aforesaid , We the American Bank of Albania , hereby irrevocably undertake to pay any sum of the aforementioned subsequent payments You may claim from Us, but not exceeding the amount of expired installments upon receipt of your first demand in writing, wherein You, Finanziaria Saccarifera Italo Iberica spa, declare that the Buyer failed to meet the contractual payment obligation of the aforementioned contract.

American Bank of Albania shall not oppose to you, Finanziaria Saccarifera Italo Iberica spa, any exception and shall not have the benefit of earlier demand.

The payment by American Bank of Albania shall take place within the maximum time period of 5 ( five ) days from receipt of the aforementioned first demand in writing; in no case may be refused, delayed or suspended.

Our liability under the guarantee will expire on the thirtieth day after the expiry of each installment.

This guarantee is subject to

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NIKOLLA A PAPA
NOTER
TIRANE

## *SUCRALBA SH.P.K.*

## VENDIM

## I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

**Nr. ___ date 04/10/2004**

Ortaku i vetem i shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k.:

**Shoqeria "OERT" sh.p.k.** – perfaqesuar nga ortaket e saj z. Ilir Koka, z. Lefter Koka e z. Leonard Koka,

te mbledhur ne seline e shoqerise sot me 04/10/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise, pasi shqyrtuan zhvillimet e pesuara nga shoqeria "Sucralba" sh.p.k. ne perberjen e ortakeve dhe te zoterimit te pjeseve te kapitalit themeltar dhe domosdoshmerine e pershtatjes se Statutit te shoqerise me kushtet aktuale, unanimisht,

## VENDOSEN

1- Ndryshimin e statutit te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. duke e pershtatur me gjendjen aktuale te saj, ne lidhje me ortakun e vetem te saj, shoqerine "OERT" sh.p.k. dhe zoterimin prej saj te 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te "Sucralba" sh.p.k.
2- Miratimin e Statutit te ri te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. te riformuluar, bashkangjitur ketij vendimi.
3- Autorizohet administratori i shoqerise z. Ilir Koka te nenshkruaje te gjitha aktet e nevojshme per pasqyrimin e ketij ndryshimi.
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

**ORTAKU I VETEM**

**Shoqeria "OERT" sh.p.k.**

Perfaqesuar nga Ortaket

Ilir Koka | Lefter Koka | Leonard Koka

**Republika e Shqipërisë**

**Dhoma e Noterisë Tiranë**

**Nr.** 1877 **Rep.**

## VËRTETIM

Vërtetohet se sot më 05. Tetor /2004 në Tiranë, para meje M. Gopo, Noter Publik me seli në rrugën "R. Gollobeur", u paraqitën personalisht, z. Ilir Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1955, lindur e banues në Durrës, rruga "A.Goga", pall.971, ap.7, z. Lefter Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1964, lindur e banues në Durrës, z. Leonard Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1966, lindur e banues në Durrës, të identifikuar sipas ligjit nga dokumentat e tyre personale, në cilësinë e ortakëve të shoqërisë "OERT" sh.p.k., të gjithë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan se kanë hartuar këtë akt jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan para meje rregullisht. Unë, Noteri vërtetoj me nënshkrimin tim sipas ligjit.

**NOTER**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTER TIRANE

***SUCRALBA SH.P.K.***

**VENDIM**

**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE**

**Nr. ___ date 22/09/2004**

Ortaket e shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k.:

1– shoqeria "Finanziaria Saccarifera Italo Iberica" s.p.a. – perfaqesuar nga z. Alberto Cacciaguerra.
2 – shoqeria "OERT" sh.p.k. – perfaqesuar nga administratori z. Ilir Koka,

te mbledhur ne seline e shoqerise sot me 22/09/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise, pasi shqyrtuan miratimin e dhene nga ortaku FSII s.p.a. per transferimin e plote te pronesise se 1421 kuotave ose 58 % te kapitalit themeltar ortakut OERT sh.p.k. dhe largimin e saj si ortak i shoqerise "Sucralba" sh.p.k., meqenese garancia bankare e kerkuar eshte leshuar nga OERT sh.p.k., mbeshtetur ne nenin 4 te kontrates se shitblerjes se kuotave dhe ne nenin 12 te statutit te shoqerise, unanimisht,

**VENDOSEN**

1- Tranferimin e plote te pronesise se 1421 kuota ose 58 % te kapitalit themeltar te shoqerise Sucralba" sh.p.k. te ortaku shoqeria "OERT" sh.p.k.
2- Largimin e shoqerise "FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBERICA" s.p.a. nga pjesmarrja ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k.
3- Ndryshimin e Statutit dhe Aktit te Themelimit per sa i perket pjesmarresve si ortake te "SUCRALBA" sh.p.k. qe ndryshon dhe behet:
   - shoqeria OERT sh.p.k. me 2450 kuota ose 100 % te kapitalit themeltar
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

ORTAKET

**Shoqeria FSII S.p.A.**
**Perfaqesuesi**

**Dr. Alberto Cacciaguerra**

Alberto Cacciaguerra

**Shoqeria OERT sh.p.k.**
**administratori**

**Ilir KOKA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1812 Rep.

# VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 27 Shtator 2004 (dymijekater) para meje Mimoza Papa Notere me seli ne rrugen " Reshit Collaku", Nr. 7, u paraqit personalisht z Ilir Koka, i biri Hakiut ,i datelindjes 1955, banues ne Durres,i njohur personalisht prej meje,madhor me zotesi te plote per te vepruar,zoti Alberto Cacciaguerra, me kombesi e shtetesi italiane, i datelindjes 1934, i identifikuar me Pasaporten Nr.318566,madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e perfaqesuesit te shoqerise " FSII" S.p.a, te cilet me deklaruan se kane hartuar Vendimin e shoqerise jashte kesaj zyre dhe nenshkruan para meje rregullisht, une Noteri e vertetoj sipas ligjit .

NOTERE

Mimoza Papa

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MIMOZA PAPA
NOTER
TIRANË

# STATUTI

# I

# SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SUCRALBA" SH.P.K.

Subjekti që nënshkruan më poshtë:

**- Shoqëria "OERT" sh.p.k.**

në përputhje me ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nënshkruan këtë Statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

## OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK

### Neni 1. Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie:

- Ndërtimi i linjës së prodhimit dhe vënia në shfrytëzim e impiantit prodhues dhe përpunimi e shitja e sheqerit të konfeksionuar dhe në thasë, si dhe të prodhimeve të tjera ushqimore, me të gjitha përpunimet plotësuese të domosdoshme ose të nevojshme, në vartësi me llojet e ndryshme të prodhimit.

Ky objekt i veprimtarisë mund të realizohet tërësisht ose në mënyrë progresive.

Për arritjen e objektit të shoqërisë dhe të pikësynimeve për realizimin e tij, ajo do të ndërmarrë dhe do të zhvillojë çfarëdo lloj veprimtarie industriale, tregtare, me pronësinë e sendeve të paluajtëshme dhe financiare, që do të konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme për qëllimet e shoqërisë.

**Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë**

2.1. Emërtimi i shoqërisë është **"SUCRALBA" sh.p.k.**

2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Durrës, Rruga "Dalip Peza" nr.12. Transferimi i qendrës së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me aprovimin e ortakëve që zotërojnë ¾ e pjesëve të kapitalit themeltar.

2.3. Shoqëria mund të krijojë qëndra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit me vendim të shumicës së Asamblesë, dmth. me ¾ e votave të shprehura.

**Neni 3. Rregjimi juridik**

3.1. Shoqëria është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

3.2. Me vendim të sajin, Asambleja e Ortakëve mund të ndryshojë rregjimin juridik të Shoqërisë, nëqoftëse në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast, Ortakët do të përshtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë rregjistrimin e saj në Rregjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

## TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

**Neni 4 Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve**

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NOTER

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve ndaj të tretëve dhe as ortakët nuk mbajnë përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsipër shoqëria.

4.5. Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

4.6. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Shoqërisë. Për këtë gëzon të drejtën që të caktojë një person të emëruar prej tij që të marrë informacion.

4.7. Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 5 Kohëzgjatja**

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë 50 vjeçare, duke filluar nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar.

5.2. Shoqëria mund të prishet para kohe ose të shtyjë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

Kreu III

**KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

**Neni 6**

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është **215.266.800 lekë**, i vënë në masën 100% nga Ortakët si më poshtë:

**- shoqëria "OERT" sh.p.k.** 215.266.800 lekë përkatësisht 100 % të kuotave.

6.2. Kapitali themeltar është i ndarë në **2 450 pjesë** tërësisht të nënshkruara e të shlyera, duke patur secila prej tyre një vlerë nominale prej **87 864 lekë**.

**Neni 7 – Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të shtohet pa kufi, në çfarëdo momenti, një ose më shumë herë, me vota të shprehura në Asamblenë e Jashtëzakonshme të Ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën ¾ e kapitalit themeltar.

Në rastin kur vendoset zmadhimi i kapitalit themeltar të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë shtimin në raport me pjesët e kapitalit që zotërojnë. Në rast se nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë në mënyrë proporcionale sipas kuotave që zotërojnë.

**Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar, nëpërmjet votimit "pro" të ortakëve të pranishëm ose të përfaqsuar që zotërojnë të paktën ¾ e kapitalit themeltar.

Zvogëlimi i kapitalit bëhet nga çdo ortak në mënyrë proporcionale me kuotat që zotëron.

Ky kapital nuk mund të jetë më i vogël se minimumi që lejon ligji.

**Neni 9 – Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortakët, personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën ¾ e (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar.

Në këtë rast, nga ana e ortakëve mund të caktohet një ekspert apo grup ekspertësh kontabël (një nga secili ortak), ku ky akt ekspertimi do të përcaktojë vlerën e kuotave të kapitalit të ortakut që i shet këto kuota.

Në rast se shoqëria nuk jep miratimin e transferimit, ortakët, brenda 3 muajve nga kjo datë, duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën e përcaktuar si më sipër.

Kreu III

## DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

### Neni 10

10.1 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt privat pranë organit tatimor.

10.2 Emërtimi i Shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentat që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve.

10.3 Organet kryesore të Shoqërisë janë: Asambleja e Ortakëve, Administratori dhe eventualisht Eksperti Kontabël i Autorizuar.

### Neni 11

### Asambleja e Ortakëve të shoqërisë

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe vendimet e saj janë të detyrueshme.

Të drejtën e thirrjes së Asamblesë e kanë Administratori, Eksperti Kontabël i Autorizuar ose një nga ortakët të cilët zotërojnë të paktën 1/10 e kapitalit themeltar të shoqërisë. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve bëhet me letër rekomande të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes, duke parashtruar rendin e ditës dhe dokumentacionin që do të shqyrtohet. Mbledhja e Asamblesë thirret detyrimisht një herë në vit dhe jo më vonë se fundi i 6-mujorit të parë në vazhdim.

Votat e ortakëve kanë vlerë proporcionale me pjesën e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamble nëpërmjet një ortaku tjetër ose nëpërmjet një përfaqësuesi, duke qënë këta të autorizuar me prokurë të posaçme, dhe të marrin vendime vetëm për ato çështje që diskutohen në mbledhjen për të cilën ata kanë marrë të drejtën e përfaqësimit.

Një ortak nuk mund të ngarkojë një mandatmbajtës të votojë në emër të një pjese të kapitalit të tij themeltar, duke votuar ai vetë në emër të pjesës tjetër të kapitalit të tij themeltar.

Asambleja, zgjedh me rotacion një herë çdo 6 muaj, nga rradhët e ortakëve të Shoqërisë një Kryetar të Asamblesë, i cili thërret mbledhjet e Asamblesë dhe drejton këto mbledhje.

Mbledhjet e Asamblesë pasqyrohen në proçesverbalin që mbahet me këtë rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortakët.

Proçes-verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

Asambleja e zakonshme merr vendime me shumicën e votave të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar që përfaqësojnë më shumë se 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë.

***<u>Asambleja e zakonshme</u>*:**

- Miraton politikën e përgjithshme të zhvillimit të shoqërisë dhe buxhetin përkatës.
- Miraton pjesmarrjen në shoqëri të tjera.
- Miraton bilancin, llgaritë vjetore dhe ndarjen e fitimit ndaj ortakëve.
- Emëron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe shkarkon ekspertin kontabël.
- Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë ose ky Statut.

***Asambleja e Jashtëzakonshme*:**

Asambleja e Jashtëzakonshme merr vendime të vlefshme me ¾ e votave të ortakëve që zotërojnë kuota në shoqëri.

Asambleja e Jashtëzakonshme:

- Vendos për ndryshimet në statut ose të zëvendesojë me një statut të ri këtë statut të shoqërisë,
- Vendos zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë,
- Vendos për transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar personave të tretë, jo ortakë, nga ortakët e shoqërisë,
- Vendos për prishjen e shoqërisë ose likuidimin e saj,
- Vendos në lidhje me çdo çështje tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit ose ky Statut.

Mbledhjet e Asamblesë së Jashtëzakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen në arkivin e shoqërisë.

Kreu V

## ADMINISTRIMI

**Neni 12**

12.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë rradhëve të ortakëve të shoqërisë.

12.2 Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve.

12.3 Administratimi i shoqërisë do të bëhet nga **Administratori** i saj, **z. Ilir Koka**.

12.4 Administratori i vetëm i ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj.

12.5 Administratorit të vetëm i takon firma e lirë dhe përfaqësimi i Shoqërisë ndaj të tretëve në veprime, proçedura dhe seanca gjyqësore, arbitrazhi ose administrative.

REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTER TIRANE

12.6 Administratori është përgjegjes, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.

12.7 Kompetencat kryesore të administratorit në Shoqëri janë:

- Të hartojë raportin e administrimit, oragnizimin e kryerjen e inventareve dhe planet e llogarive ekonomike vjetore dhe t'ia paraqesë për miratim Asamblesë së Ortakëve brënda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- Përgatitja e tekstit të vendimeve që do t'i propozohen për miratim Asamblesë së Ortakëve.
- Vënien në dispozicion të Asamblesë së Ortakëve, 15 përpara mbledhjes, të raportit të ekspertit kontabël.
- Përgjigjen pyetjeve me shkrim të ortakëve në mbledhjen e Asamblesë.
- Sigurimin e zbatimit me saktësi të vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, organizimin e punës për realizimin e objektit të shoqërisë dhe raportimin për kryerjen e detyrave.
- Administrimin e pasurisë së Shoqërisë, duke përfshirë mjetet financiare, brënda caqeve të lejuara nga Asambleja.
- Kryerjen e të gjitha veprimeve bankare në interes të shoqërisë.
- Për çdo transaksion që kalon vlerën e 100 000 USD, duhet të marrë më parë miratimin me shkrim nga Asambleja e Ortakëve.
- Të përfaqësojë Shoqërinë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj dhe të mbrojë interesat e saj në gjykatë apo arbitrazh, nënshkrimin e kontratave në emër të shoqërisë dhe ndjekjen e zbatimit të tyre.
- Ti propozojë Asamblesë për miratim strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- Ti propozojë Asamblesë për miratim numrin e punonjësve të Shoqërisë, pagat dhe emërimin e shkarkimin e tyre.

**Neni 13 – Marrëveshjet e ndaluara**

13.1.1 Administratorëve ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë.

13.1.2 Kjo masë zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

Kreu VI

**VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**

**Neni 14**

14.1 Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë i cili fillon në datën e rregjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar.

14.2 Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve.

14.3 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

14.4 Të ardhurat neto të Shoqërisë që rezultojnë nga bilanci do të shpërndahen si vijon: 5% për fondin rezervë, deri sa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar; pjesa tjetër i takon Ortakëve të shoqërisë në raport me pjesmarrjen e tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 15 – Kontrolli i Shoqërisë**

15.1 Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, i emëruar nga Asambleja e Ortakëve. Eksperti kontabël duhet të përmbushë kërkesat

e neneve 168 e 169 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar garanton që llogaritë vjetore të shoqërisë janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqërisë, kontrollon përshtatjen e kontabilitetit me ligjin në fuqi, verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacionit të dhënë në raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarisë, dokumentat kontabël dhe rregjistrat e proçes-verbaleve. Mund të aktivizpjë ekspertë dhe bashkëpunëtorë për të përballuar volumin e punës, por duke marrë më parë miratimin e Asamblesë së Ortakëve. Eksperti kontabël i autorizuar mund të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve.

15.3 Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

Kreu VII

## PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

### Neni 16

16.1 Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortakët.

16.2 Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij proçesi, Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

16.3 Në fund të proçesit të likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe mbylljen e proçesit të likuidimit.

16.4 Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuidatori ndan kapitalet e mbetura për Ortakët e shoqërisë.

**Neni 17 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet midis ortakëve, shoqërisë dhe të tretëve në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Kreu VIII

## DISPOZITA TË FUNDIT

**Neni 18**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do t'i bëhet referim Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe legjislacionit koherent.

Ky Statut hartohet në katër kopje, secila me të njëjtën vlerë ligjore. Njëra prej kopjeve ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**Shoqëria "OERT" sh.p.k.**

**Ortakët**

**ILIR KOKA** **LEFTER KOKA** **LEONARD KOKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NOTER TIRANË

**Republika e Shqipërisë**
**Dhoma e Noterisë Tiranë**
**Nr. 1878/264 Rep.**

# VËRTETIM

Vërtetohet se sot më 04. Tetor /2004 në Tiranë, para meje M. Papa, Noter Publik me seli në rrugën "R. Zallatan", u paraqitën personalisht, z. Ilir Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1955, lindur e banues në Durrës, rruga "A.Goga", pall.971, ap.7, z. Lefter Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1964, lindur e banues në Durrës, z. Leonard Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1966, lindur e banues në Durrës, të identifikuar sipas ligjit nga dokumentat e tyre personale, në cilësinë e ortakëve të shoqërisë "OERT" sh.p.k., të gjithë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan se kanë hartuar këtë akt jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan para meje rregullisht. Unë, Noteri vërtetoj me nënshkrimin tim sipas ligjit.

**NOTER**
Mimoza Papa

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

T-ETOR2004

20529/4 3 P. Coro 04.10.2004

04 TETOR2004

# KERKESE

| | |
|---|---|
| ***Kerkues:*** | Ilir Koka, i biri i Hakiut,i datelindjes 1955, lindur e banues ne Durres, administrator i shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k. |
| ***Objekti:*** | Pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te akteve per ndryshimin e Statutit te shoqerise. |
| ***Baza ligjore:*** | Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar". |

***Perpara Gjykates se Shkalles se Pare***
***Tirane***

Shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane.
Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., e perbere nga ortaku i vetem, shoqeria "OERT" sh.p.k., me Vendimin date 04/10/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, ka vendosur:

1- Ndryshimin e statutit te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. duke e pershtatur me gjendjen aktuale te saj, ne lidhje me ortakun e vetem te saj, shoqerine "OERT" sh.p.k. dhe zoterimin prej saj te 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te "Sucralba" sh.p.k.
2- Miratimin e Statutit te ri te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. te riformuluar, bashkangjitur ketij vendimi.
3- Autorizohet administratori i shoqerise z. Ilir Koka te nenshkruaje te gjitha aktet e nevojshme per pasqyrimin e ketij ndryshimi.
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Perfundimisht kerkoj pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Statutit te ri te shoqerise "Sucralba" sh.p.k..

***ADMINISTRATORI***

***ILIR KOKA***

**Republika e Shqipërisë**
**Dhoma e Noterisë Tiranë**
**Nr. 1876 Rep.**

## VËRTETIM

Vërtetohet se sot më 05. Tetor - /2004 në Tiranë, para meje M. Topa, Noter Publik me seli në rrugën R. Ecollaku, u paraqit personalisht, z. Ilir Koka, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1955, lindur e banues në Durrës, rruga "A.Goga", pall.971, ap.7, përfaqësues i shoqërisë "OERT" sh.p.k. identifikuar sipas ligjit, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili deklaroi se ka hartuar këtë akt jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan para meje rregullisht. Unë, Noteri vërtetoj me nënshkrimin tim sipas ligjit.

**NOTER**



20529/1   3 A. Cigoo 13.11.2002

13/11/2002 **KERKESE**

***KERKUES***: Lefter Koka, I biri I Hakiut,I datelindjes 1964,lindur e banues ne Durres, administrator I shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k.

***OBJEKTI***: Pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar:

1- Vendimin e Asamblese se Ortakeve date 12.11.2002 .

2- Kontraten e shitblerjes se kuotave date 12.11.2002 .

***BAZA LIGJORE***: Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar".

***Perpara Gjykates se Shkalles se Pare***
***Tirane***

Shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane. Shoqeria perbehet prej tre ortakesh, shoqerise italiane "SFIR"s.p.a., shoqerise "OERT" sh.p.k. dhe shoqerise italiane "SIMEST"s.p.a..

Ortaket e shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k. ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, me Vendimin e tyre date 12. 11. 2002, kane vendosur:

1- Aprovimin e kerkeses se ortakut SFIR s.p.a. per shitjen e 1054 kuotave 43.02 % te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqerine "SUCRALBA" sh.p.k. shoqerise italiane FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a.
2- Pranimin e shoqerise FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. si ortake te shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k., si pjesmarrese me 43.02 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.
3- Ndryshimin e Statutit dhe Aktit te Themelimit per sa I perket pjesmarresve si ortake te "SUCRALBA" sh.p.k.
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane gjykates se Rrethit Tirane.

Ne vijim te ketij vendimi, midis SFIR s.p.a. dhe FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. u nenshkrua kontrata e shitblerjes se kuotave me Nr. 1939 Rep. e Nr. 880 Kol. date 12. 11. 2002, me ane te se ciles shoqeria FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. behet ortake e shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k. me 43.02 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Perfundimisht kerkoj pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar:

1- Vendimin e Asamblese se Ortakeve date 12. 11. 2002 .
2- Kontraten e shitblerjes se kuotave date 12. 11. 2002 .

***ADMINISTRATORI***

***LEFTER KOKA***

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***NOTERIA TIRANE***
***Nr. 1940 Rep.***

## *VERTETIM*

Ne Tirane, sot me date 12. 10 /2002, para meje Mimoza Papa, Noter Publik me seli ne rrugen "R.Çollaku" pallatet Shallvare, u paraqit personalisht z.Lefter Koka, I biri I Hakiut, I datelindjes 1964, identifikuar sipas ligjit, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, I cili deklaroi se ky akt I hartuar jashte kesaj zyre noteriale eshte ne perputhje me vullnetin e tij te lire e te plote dhe nenshkroi rregullisht para meje. Une, noterja, e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
Mimoza Papa

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE

20529/2

14 KORRIK 2004

## *KERKESE*

***Kerkues***: Ilir Koka, i biri i Hakiut,i datelindjes 1955, lindur e banues ne Durres, administrator i shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k.

***Objekti***: Pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te dokumentave per ndryshimet ne zoterimin e kuotave dhe pjesmarrjen e ortakeve ne shoqeri.

***Baza ligjore***: Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar".

### *Perpara Gjykates se Shkalles se Pare Tirane*

Shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane. Shoqeria perbehet prej tre ortakesh, shoqerise italiane "SFIR"s.p.a., shoqerise "OERT" sh.p.k. dhe shoqerise italiane "SIMEST"s.p.a..

Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., me Vendimin nr.__ date 30/06/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, bazuar ne nenin 7 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 12 te Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

1- Aprovimin e kerkeses se ortakut SIMEST S.p.A. per shitjen e 367 kuotave (14.98 %) te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqerine "SUCRALBA" sh.p.k., shoqerise FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a.
2- Ndryshimin e Statutit dhe Aktit te Themelimit per sa i perket pjesmarresve si ortake te "SUCRALBA" sh.p.k. qe ndryshon dhe behet:
   - shoqeria FSII S.p.A. me 1421 kuota ose 58 % te kapitalit themeltar
   - shoqeria OERT sh.p.k. me 1029 kuota ose 42 % te kapitalit themeltar
3- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Ne vijim te ketij vendimi, midis SIMEST s.p.a. dhe FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. u nenshkrua kontrata e shitblerjes se kuotave me Nr. 1276 Rep./ 199 Kol. date 30/06/2004, me ane te se ciles shoqeria FINANZIARIA SACCARIFERA ITALO IBBERICA s.p.a. behet ortake e shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k. me 58 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Perfundimisht kerkoj pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te dokumentacionit perkates.

***ADMINISTRATORI***

***ILIR KOKA***

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1342 Rep.Nr. – Kol.

# VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 12 Korrik 2004 (dymije kater ), para meje Mimoza Papa, Notere me seli ne rrugen " Reshit Collkau", pallatet e Shallvareve, u paraqiten personalisht zoti Ilir KOKA , i biri i Hakiut i datelindjes 1955, banues ne Durres, i njohur personalisht prej meje, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i cili me deklaroi se e ka hartuar kete kerkese jashte kesaj zyre dhe nenshkroi para meje rregullisht , une Noteri e vertetoj me nenshkrimin tim sipas Ligjit Nr. 7829 date 01.06.1994 " Per Noterine " .

NOTERE
Mimoza Papa

REPUBLIKA E SHQIPERISE MIMOZA A PAPA NOTER TIRANË

20529/3
27/09/2004

S A Coro
27 09 2004

27 SHTATOR 2004

*KERKESE*

***Kerkues***: Ilir Koka, i biri i Hakiut,i datelindjes 1955, lindur e banues ne Durres, administrator i shoqerise "SUCRALBA" sh.p.k.

***Objekti***: Pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te dokumentave per ndryshimet ne zoterimin e kuotave dhe pjesmarrjen e ortakeve ne shoqeri.

***Baza ligjore***: Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar".

***Perpara Gjykates se Shkalles se Pare***
***Tirane***

Shoqeria "SUCRALBA" sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik ne Rregjistrin Tregtar me Vendimin nr.20529 date 11.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Sucralba" sh.p.k., me Vendimin nr.__ date 22/09/2004, ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, bazuar ne nenin 4 te Kontrates se shitblerjes se kuotave dhe ne nenin 12 te Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

1- Transferimin e plote te pronesise se 1421 kuota ose 58 % te kapitalit themeltar te shoqerise "Sucralba" sh.p.k. te ortaku shoqeria "OERT" sh.p.k.
2- Largimin e shoqerise "Finanziaria Saccarifera Italo Iberica" S.p.A. nga pjesmarrja ne shoqerine "Sucralba" sh.p.k.
3- Ndryshimin e Statutit dhe aktit te themelimit per sa i perket pjesmarresve si ortake te "Sucralba" sh.p.k. qe ndryshon dhe behet:
   - shoqeria "OERT" sh.p.k. me 2450 kuota ose 100 % te kapitalit themeltar.
4- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Perfundimisht kerkoj pasqyrimin e ndryshimeve dhe depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te dokumentacionit perkates.

***ADMINISTRATORI***

***ILIR KOKA***

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1811 Rep.

# VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 27 Shtator 2004 (dymijekater) para meje Mimoza Papa Notere me seli ne rrugen " Reshit Collaku", Nr. 7, u paraqit personalisht z Ilir Koka, i biri Hakiut ,i datelindjes 1955, banues ne Durres,i njohur personalisht prej meje,madhor me zotesi te plote per te vepruar, i cili me deklaroi se ka hartuar kerkesen jashte kesaj zyre dhe nenshkroi para meje rregullisht, une Noteri e vertetoj sipas ligjit .

NOTERE

